



Thirrje për shprehje të interesit për partneritet

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë nga shtatori i vitit 2019 ka filluar zbatimin e projektin regjional “Fuqizimi dhe aftësimi i të rinjve përmes mundësive të reja (YEPP)”, projekt i financuar nga Ministria Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ).

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë së bashku me SOS Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni dhe Serbi si dhe Herman Gmeiner Fund Development (HGFD) është në procesin e aplikimit për fazën e dytë të projektit regjional “Fuqizimi dhe aftësimi i të rinjve përmes mundësive të reja (YEPP2)” dhe është në kërkim të partneritetit me OJQ-të tjera vendore të cilat në fushëveprimin e tyre e kanë edhe punën me të rinjtë të marginalizuar.

Me qëllim të finalizimit të procesit të aplikimit tek BMZ, SOS Fshatrat e Fëmijëve ka hapur thirrjen për shprehje të interesimit për partneritet për OJQ -të vendore cilat veprojnë në: Prizren, Gjiçan, Pejë, Mitrovicë dhe Ferizaj, të cilat veç tjerash në fokus të punës së tyre kanë të rinjtë e marginalizuar dhe punësimin e tyre.

Organizatat joqeveritare vendore (OJQ) të cilat veprojnë në Prizren, Gjiçan, Pejë, Mitrovicë dhe Ferizaj mund ta shprehin interesimin e tyre për partneritet duke dërguar në email adresën info@soskosova.org dokumentet në vijim:

- ▶ Rezyme të organizatës dhe qytetin në të cilin veprojnë OJQ (formatin e rezymësë së organizatës mund ta shkarkoni në këtë link: <https://www.soskosova.org/wp-content/uploads/2022/09/Formati-Rezymese.docx>)
- ▶ Certifikatën e regjistrimit në Kosovë;
- ▶ Statutin e organizatës

Thirrja për partneritet është e hapur deri me datën **04 tetor 2022**

Çfarëdo pyetje që mund të keni rreth shprehjes së interesimit për partneritet mund të na shkruani në emailin info@soskosova.org.

Përshkrimin e detajuar të kësaj thirrje mund a shkarkoni nga vegëza në vijim: <https://www.soskosova.org/shpallje/>